

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Po ku ishte ti o zot!', këndohet në Prishtinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/po-ku-ishe-ti-o-zot-kendohet-ne-prishtine-i587099
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 14:13:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8617c1589e3e18d7f349382b05114bfb8154968281e1753169d0879eb0dc4cc3
TEKSTI	1b212e9fadde8f12ecfd58f672f6d4d3b7e38f1ffbdf325c2099233f741d9426
PAMJA	b630b775c0d33176c8ea045edfe706e3674f5ea46dffe9da1e1ba481b860953b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5e4415b6f7e40f956c75a109501049d81f80c3e7c5f7fa160493c712a10475dd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5e4415b6f7e40f956c75a109501049d81f80c3e7c5f7fa160493c712a10475dd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 English



ie "El Nino" ne prag te nje rekordi te ri, temperaturat po rriten ndjeshem Shperndanin kokaine me makine ne qytetin e Lacit, "Destinacioni" prangos 2 te rinjte nga Tirana dhe fundit

'Po ku ishe ti o zot!', këndohet në Prishtinë



19 Shtator 2026, 17:15 Blog TEMA



Nga Frok Çupi

Në Prishtinë ka kakofoni zërash, sidomos tani pasi 'të zotët e shtëpisë' u dënuan përjetë në Hagë. Sepse përjetë u dënuan, jo 'përjetën e tyre'; ata një ditë mund të kthehen.

Por nuk do të përgjigjet askush. Të trokasin nëpër pragje dhe dyer: 'A ka zot kjo shtëpi!... A ka zot?!'. Por kaq.

Një artist i madh i Shqipërisë, Sherif Merdani, pësoi të njëjtin fat. E burgosën thuajse një jetë. Kur erdhi nga burgu, Tiranës i erdhi vetë 'Zoti' i mohuar. Domethënë e drejta për t'i kënduar dhe, aq më shumë, për ta kërkuar zotin 'ku ishe kur na duheshe?'.

"Po ku ishe ti, o zot/ Për një çast kur të kërkuam", thotë Merdani në zërin e tij.

A ka zot Prishtina 'në këtë çast' që ia kanë burgosur bijtë, çlirimtarët?

Tani janë çliruar rrugëve, si zotat, edhe djajtë. Edhe daj ka shumë; mos u mahnitni vetëm me këngët marsh luftarak për UÇK, as për flamujt që tunden cep më cep me mijëra. Djajtë, si në Prishtinë edhe në Tiranë, po përhapin imagjinata, fjalë, shpifje heroike, vulgaritet..., sikur çlirimtarët ishin 'vrasës të vëllezërve, për pushtet'.

Të tjerët kanë triumfuar, por pa treguar fytyrën, sepse kanë dëshmuar se 'na vrau Hashim Thaçi'. 'Na doli e drejta!', po thonë, përveç Gecit, të tjerët pa fytyrë.

'Edhe lopën që i humbi dikujt, ia kishte pas rrëmbyer Hashim Thaçi'.

Atëherë, vallë, gjykatësi Charles Smith a u dashka mallkuar pse edhe ai bazohet në imagjinata. Jo vetëm në imagjinata, por dëshmi shqiptare. Ai shkruan diku se e dinte 'që Hashim Thaçi e dinte' krimin e tjetrit. Zigmuth Frojd do ta kishte blerë shtrenjtë gjykatësin si kavje psikologjike.

Ku ishte Zoti 'në atë çast'? Dëshmia e tij do ta zgjidhte punën? Përderisa dëshmia e Amerikës dhe e NATO-s që udhëhoqën e fituan luftën Çlirimtare në Kosovë, nuk vlen; atëherë as zoti i qiellit nuk do të vlente. As e drejta hyjnore nuk do të 'pijë ujë' për lirinë e një populli.

Tani zoti i të drejtës ka marrë fytyrë njeriu.

Po lëvizin nëpër Prishtinë. A lëvizin për mirë, apo për keq, kjo nuk merret vesh. Ka zhurma, ka edhe dëshira të këqija. Ka amnezi për historinë. Ka politikanë që thërresin ‘përjetë në burg’. Ka të tjerë që thonë se ‘nuk ka shtet pa Çlirimtarët’. Grupimet politike janë pozicionuar, në mënyrë hipokrite sa ‘pro tyre’, aq edhe ‘kundër’. Gjykatësi Smith e di këtë. Edhe vetë gjykimi i historisë së shqiptarëve e di se ‘në atë çast’ si të Sherif Merdanit, shqiptarët nuk janë një zot, por shumë zota.

Politika po luan rol të kamufluar.

Grupimi politik i ardhur direkt nga UÇK dhe që quhet PDK, u dorëzua të LVV. Zoti Hamza, si Hamzai i Kastriotëve, i çoi Kurtit në çini kokën e Hashim Thaçit.

I trokiti në derë dhe i dha tagrin që ‘lirimin e Thaçit ta zgjidhin bashkë’. Kurti dhe VV kanë luftuar me thikë në gojë kundër Thaçit. Kundër çlirimtarëve dhe vetë shtetit të ri të Kosovës.

Lëvizja Demokratike e Kosovës, që ideoi Republikën, ka harruar luftën dhe vetë atin e tyre, Ibrahim Rugovën. Këta e kanë harruar ‘kokën e tyre’, s’ka se si akuzohen pse dorëzuan kokën e Hashim Thaçit.

Dënimi i bujshëm dhe tragjik i çlirimtarëve është më së shumti dëshmi e veprës së keqe të viktimave që i shpëtuan tiranisë për shkak të luftës së çlirimtarëve. Të bëhet viktima ‘zot i keq’, ky është fundi.

Se ku ishte atëherë zoti i Merdanit, këtë e kërkon vetëm arti, jo mundësia.

Koha mund të kalojë duke kënduar në rrugët e Prishtinës, duke i kënduar flamurit dhe UÇK-së. Por kjo do të jetë mbulesa më djallëzore e profilit të Zotit. Ndërsa viktimat mund të mos përballojnë dot lirinë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Shteti që mëson

11:59 Blog / 3 komente

[Se per ta, ma e rresoves ishte e para](#)

22:18 Blog / 2 komente

[Metamorfoza 3: Zengjinët e rinj nga mushkat me hashash deri tek jahtet për të dashurat](#)

17:05 Blog / 3 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.